

Vendim nr.113 datë 15.04.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji, Kryetare
Genti Ibrahim, Anëtar
Marsida Xhaferllari, Anëtare

në datën 15.04.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 11 (E) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: EDMOND KASMI

OBJEKTI: Konstatimi i shkeljes të parimit të barazisë së shtetasve përpara ligjit. Konstatimi i cenimit të sigurisë juridike dhe cenimit të besimit të publikut, pasi Gjykata e Lartë duhet t'i trajtojë njëloj çështjet e ngjashme ose t'i trajtojë në mënyrë të barabartë kur janë çështje dhe rrethana identike si në rastin konkret.

Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-1603 (252), datë 21.10.2025 të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Pezullimi i zbatimit të vendimit nr. 00-2025-1603 (252), datë 21.10.2025 të Gjykatës së Lartë, duke urdhëruar rishqyrtimin përpara Gjykatës së Lartë ose çdo disponim, masë tjetër të përshtatshme, për rivendosjen plotësisht të të drejtave themelore të ankuesit dhe të afërmve të tjerë që tashmë kanë (ose duhet të kenë) statusin e viktimës në këtë çështje.

Gjykimi i çështjes brenda juridiksionit të posaçëm për subjektet dhe veprat e posaçme penale referuar nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale sikurse

Gjykata e Lartë ka argumentuar dhe urdhëruar në vendime të mëparshme.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka depozituar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) një kallëzim penal ndaj disa punonjësve të institucionit financiar jobankar “Fondi Besa” sh.a., për kryerjen prej tyre të disa veprave penale, ndër të tjera, “Organizata kriminale”, “Grupi i strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuara nga nenet 28, 333, 333/a e 334 të Kodit Penal (*KP*). Prokuroria e Posaçme e ka regjistruar kallëzimin penal me nr. K 1127 prot., datë 06.09.2024.

2. Pas studimit të materialit kallëzues, Prokuroria e Posaçme ka vlerësuar se nuk ndodhej përpara kryerjes së veprave penale të kallëzuara dhe se nuk konstatoheshin indice për ekzistencën e ndonjë vepre tjetër penale ose subjekti që të jetë në kompetencë lëndore të saj, në kuptim të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*). Për këtë arsye, drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme me aktin nr. K 1127/1 prot., datë 09.09.2024, me lëndë “Dërgohet materiali kallëzues për vlerësim”, ia ka përcjellë materialet Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (*Prokuroria e Zakonshme*).

3. Kërkuesi e ka kundërshtuar aktin e Prokurorisë së Posaçme në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), duke pretenduar se nuk janë kryer hetimet e nevojshme, pas përfundimit të të cilave, Prokuroria

e Posaçme mund të dispononte me vendim (për mosfillimin e procedimit penal, pushimin e procedimit penal ose dërgimin e çështjes për gjykim).

4. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 524, datë 10.10.2024, ka vendosur mospranimin e ankimit, me arsyetimin se kërkuesi nuk legjitimohej për kundërshtimin e disponimit të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, i cili kishte vepruar sipas nenit 28 të KPP-së. Sipas asaj gjykate, kërkuesi mund t'i realizonte të drejtat pranë Prokurorisë së Zakonshme, e cila po ushtronte ndjekjen penale dhe vendimet e saj mund t'i ankimonte në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vënë në dukje se kalimi i kallëzimit penal për kompetencë lëndore në një prokurori të juridiksionit të zakonshëm nuk përbën mosfillim të procedimit penal, pasi, aktualisht, fakti po hetohet nga Prokuroria e Zakonshme (fakt ky i pranuar si nga kërkuesi dhe nga prokurori) dhe në përfundim të hetimeve i vetmi autoritet që ka kompetencë për të pushuar çështjen penale është gjyqtari i seancës paraprahe.

5. Mbi bazën e apelit të kërkuesit, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 220 (87-2024-316), datë 08.11.2024, ka vendosur: i) ndryshimin e vendimit nr. 524, datë 10.10.2024 të GJKKO-së së Shkallës së Parë; ii) shfuqizimin e shkresës së drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, me lëndë “Dërgohet materiali kallëzues për vlerësim”, drejtuar Prokurorisë së Zakonshme; iii) detyrimin e Prokurorisë së Posaçme për të regjistruar procedim penal sipas kallëzimit të kërkuesit; iv) detyrimin e Prokurorisë së Posaçme për të tërhequr materialin kallëzues të dërguar prej saj në Prokurorinë e Zakonshme. GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se përmes shkresës është treguar mungesë vullneti për të hetuar veprat penale të kallëzuara në fushën e krimit të organizuar, duke mos i pasqyruar ato në disponimin e Prokurorisë së Posaçme, për rrjedhojë duke shpallur moskompetencën për pjesën tjetër të veprave penale. Sipas asaj gjykate, shkresa në fjalë ka fshehur një vendim për mosfillimin e procedimit penal dhe se mënyra e disponimit nga Prokuroria e Posaçme i ka mohuar formalisht kallëzuesit të drejtën e aksesit në gjykatë, pasi e ka vënë përpara një vendimmarrje për të cilën ligji nuk parashikon ankim, sikurse është vendimi për shpalljen e moskompetencës nga ana e prokurorit. GJKKO-ja e Apelit e ka vlerësuar të drejtë analizën e GJKKO-së së shkallës së parë, sipas së cilës, bazuar në parimin e taksativitetit të ankimit ndaj vendimit të prokurorit me të cilin është shpallur moskompetenca, nuk parashikohet e drejta e ankimit. Megjithatë, sipas GJKKO-së së Apelit, gjykata e shkallës së parë nuk e ka analizuar në thelb shkresën, e cila përmban një vendim mosfillimi procedimi penal të mbuluar në formën e një shkrese përcjellëse, që as formalisht nuk i përmban elementet e një vendimi për moskompetencë.

6. Mbi bazën e rekursit të prokurorit të posaçëm, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1603 (252), datë 21.10.2025, ka vendosur prishjen e vendimit të GJKKO-së së Apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në shkallë të dytë. Sipas Gjykatës së Lartë nuk rezulton që Prokuroria e Posaçme, përmes shkresës, të ketë treguar mungesë vullneti për të hetuar veprat penale në fushën e krimit të organizuar, si dhe nuk rezulton që Prokuroria e Posaçme të ketë marrë një vendim për mosfillimin e procedimit penal sipas nenit 291 të KPP-së, që të legjitimonte kërkuesin për të depozituar ankim në gjykatë.

7. Kërkuesi në datën 12.02.2026, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankimin kushtetues individual sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. *Kërkuesi*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se nga vendimi i Gjykatës së Lartë i janë cenuar:

8.1. *Parimi i barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit*, i garantuar në nenin 18 të Kushtetutës, pasi çështja e tij është zgjidhur ndryshe nga rastet e tjera të kompetencës lëndore.

8.2. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë duhet të njësojë praktikën gjyqësore, për më tepër vendimi i saj është kontradiktor.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Kriteret paraprake të legjitimitimit janë të natyrës kumulative, ndaj, në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për

vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Kolegji evidenton se gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitimit, në varësi të elementeve dhe veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkuuesin. Thënë ndryshe, mund të ndodhë që në shqyrtimin paraprak të një çështjeje të verifikohet mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, duke sjellë si pasojë moskalimin e saj në seancë plenare.

11. Në çështjen konkrete, Kolegji çmon të ndalet në analizën e kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “F”, i Kushtetutës. Qëllimi i këtij kriteri është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatë. Kontrolli kushtetues ka funksion subsidiar, ndaj mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar të çfarëdolloj forme që përmbyll procesin gjyqësor të themelit. Cenimi i të drejtave kushtetuese mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm të të drejtave (*shih vendimet nr. 24, datë 27.04.2023; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka mbajtur qëndrimin se, përjashtimisht, kontrollit të saj i nënshtrohen edhe ato vendime të ndërmjetme, karakteri i të cilave do të konsiderohet përfundimtar për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit Organik të Gjykatës. Megjithatë, ky përjashtim zbatohet vetëm nëse plotësohen njëherazi tre kushte: (i) kur shkelja e pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm; (ii) vendimi i ndërmjetëm të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe gjykatat më të larta të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; (iii) vendimi i ndërmjetëm duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë (*shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Kolegji, referuar përmbajtjes së vendimeve gjyqësore, vëren se kërkuesi ka kundërshtuar në gjykatat e zakonshme aktin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, me të cilin i ka dërguar materialin kallëzues për kompetencë lëndore Prokurorisë së Zakonshme. Gjykatat e posaçme kanë shqyrtuar ankimin dhe procesin gjyqësor ka vijuar me vendimin e Gjykatës së Lartë që ka vendosur prishjen e vendimit të GJKKO-së së Apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, duke vlerësuar se në rigjykim duhej analizuar faza në të cilën ndodhet procedimi penal për faktet e kallëzuar

(nëse është regjistruar një i tillë) dhe dispozitat ligjore të zbatueshme (*shih paragrafët 3-6 të vendimit*).

13. Nga analiza e këtyre rrethanave, Kolegji fillimisht evidenton se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, vlerësimi i prokurorit dhe vendimet e gjykatave të zakonshme për përcaktimin e kompetencës janë akte me natyrë të ndërmjetme në procedimin penal, pasi nuk zgjidhin në themel çështjen penale. Edhe vendimi i Gjykatës së Lartë, që kthen çështjen për rigjykim, nuk konsiderohet përfundimtar, për efekte të gjykimit kushtetues. Në të tilla raste, Gjykata ka pohuar se kur procesi i themelit vazhdon të jetë në gjykim, kërkuesi i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rigjyimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë (*shih vendimet nr. 9, datë 11.02.2026; nr. 39, datë 06.07.2016; nr. 48, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Sistemi gjyqësor është një sistem korrigjues subsidiar, i cili, nga mënyra se si është ndërtuar dhe funksionon, u përgjigjet të gjitha pretendimeve për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore dhe individit ka mundësinë që në çdo hallkë, fazë ose shkallë të procesit të ngrejë pretendime konkrete. Gjykatat e zakonshme duke pasur kompetencën për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve ligjore të qytetarëve, janë në pozicionin e duhur për të filluar dhe, nëse është e nevojshme, për t’i dhënë forcë detyruese interpretimit kushtetues që mbron të drejtat themelore (*shih vendimin nr. 9, datë 11.02.2026 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Për sa më sipër, Kolegji çmon se kërkuesi nuk legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës për të kundërshtuar aktin e prokurorit për përcaktimin e kompetencës dhe vendimet gjyqësore që janë dhënë për ankimin ndaj këtij akti, pasi, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, ai ka ende mjete juridike efektive në dispozicion. Në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes të kriterëve të tjera paraprake të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

15. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.